


Kosovë: Tejkalimi i Pengesave për Pjesëmarrjen e Grave në Politikë



Mirënjohje

Instituti Kombëtar Demokratik (NDI) dëshiron të falënderojë çdo individ që ndihmoi në përmbledhjen e këtij raporti të vlerësimeve. Raporti bazohet në dokumentet e punës të zhvilluara nga Laura Nichols dhe Valon Kurhasani duke përfshirë kontribute të ndryshme nga Pranvera Lipovica. Pajtim Gashi dhe Nita Bicurri dhanë njohuri për raportin dhe komente në udhëzuesin e diskutimeve për ekipin vlerësues. Kristen Wall e bëri editimin, korrektimin dhe dha informacione pararendëse për raportin. Pjesa tjetër e stafit të NDI siguroi njohuri të dobishme dhe dha mbështetje teknike duke aranzhuar intervista dhe përkthime: Nikola Djakovic, Arlinda Zaimi dhe Aida Bejta. Përveç kësaj, NDI falënderon Meryl Frank, Robert Benjamin, Alexander Chavarria, dhe Laura Nichols për kontributet e tyre të vlefshme në vlerësim dhe raport.

Ky raport është mundësuar nga mbështetja bujare e popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) Marrëveshja e Asocimit për Bashkëpunim Nr. 167-A-00-09-00106-00, nën Marrëveshjen e Bashkëpunimit të Udhëheqësve Nr.DFD-A-00-08-00350-00. Opinionet e shprehura këtu janë ato të autorit(ëve) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

E drejta e autorit © Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), shkurt 2014. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Pjesë të kësaj pune mund të riprodhohen dhe(ose) të përkthehen për qëllime jo komerciale duke siguruar që NDI të bëhet i ditur si burim i materialit dhe t'i dërgohen kopje të çfarëdo përkthimi.

Kosovë: Tejkalimi i Pengesave për Pjesëmarrjen e Grave në Politikë



Shkurt, 2015

■ LISTA E AKRONIMEVE:

AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
CEDAW	Konventa për ti dhënë Fund të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Grave
DP	Deputet i Parlamentit
IFES	Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
NDI	Instituti Kombëtar Demokratik
ODIHR	Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
OJQ	Organizata jo Qeveritare
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkpunim në Evropë
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
UNDP	Programi për zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
VV	Vetëvendosje

■ PARATHËNIE

Nga 07 deri 11 tetor, 2014 Instituti Kombëtar Demokratik (NDI apo Instituti) ndërmori një vlerësim për pjesëmarrjen e grave në politikë në zgjedhjet lokale të 2013-ës dhe zgjedhjet parlamentare të 2014-ës. Vlerësimi u bë sipas standardeve ndërkombëtare për pjesëmarrjen e grave në politikë të zhvilluara nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE), Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara (UNDP), dhe programet globale të NDI për Gjini, Gra dhe Demokraci. Vlerësimi u përqendrua në identifikimin e sfidave ose "boshllëqeve" në rekrutimin e grave kandidate, qasjen e grave në pozita vendimmarrëse, emërimin e tyre për pozita nga partitë politike, dhe rolet e grave në kuadër të fushatave të partive politike. Bazuar në të gjeturat e vlerësimit, NDI ka zhvilluar rekomandime për të mbështetur barazinë gjinore brenda partive politike të Kosovës dhe për mbështetjen e përpjekjeve të ardhshme të reformës zgjedhore.

Ekipi i vlerësimit i NDI-së përfshiu Ambasadoren Meryl Frank, ish Ambasadoren Amerikane të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për Statusin e Grave, më parë kryetare e komunës Highland Park, New Jersey, Shtetet e Bashkuara; Laura Nichols, Drejtoreshë e lartë e NDI-së në Jemen; Alexander Chavarria, drejtor lartë i NDI-së në Kosovë; Valon Kurhasani, menaxher i lartë i NDI-së programit në Kosovë; dhe Pranvera Lipovica, menaxhere e programit të NDI-së në Kosovë.

Instituti ka përdorur tri metoda të hulumtimit për të kryer vlerësimin: intervista individuale, fokus grupe si dhe një studim on-line. Ekipi i vlerësimit është takuar me burra dhe gra që përfaqësojnë një spektër të gjerë të zyrtarëve qeveritarë, të opozitës dhe udhëheqësve të partive politike, anëtarët e parlamentit (DP), dhe përfaqësues të mediave, akademisë, shoqërisë civile dhe bashkësisë ndërkombëtare. NDI gjithashtu ka administruar një sondazh on-line nga një mostër e vetë zgjedhur prej 81 grave anëtare të partive nga i gjithë spektri politik. Nga ky numër 61 të anketuar ishin kandidatë në zgjedhjet lokale të vitit 2013, ndërsa 12 kandiduan në zgjedhjet parlamentare të 2014-ës. Së fundi, NDI zhvilloi tri fokus grupe me gra anëtare të partive në nivel të degëve që të shqyrtojnë pikëpamjet e tyre për procedurat e brendshme partiake.

Temat kyçe në vijim dolën nga vlerësimi i NDI-së :

- Ndërsa kërkesat teknike të kuotës zgjedhore të Kosovës kanë qenë të vëzhguara në përgjithësi, fryma e ligjit nuk është vëzhguar. Gratë nuk janë kultivuar si kandidate ose udhëheqëse, as nuk u është dhënë mbështetje sikurse kandidatëve meshkuj. Në disa raste, kandidatët meshkuj përdorin kuotën për të argumentuar se gratë nuk kanë nevojë për të marrë mbështetjen e partisë gjatë fushatës për shkak se ato kanë vende të garantuara.
- Përkundër pjesëmarrjes së dukshme të grave në zgjedhjet lokale të 2013-ës, partitë dhe shoqëria civile nuk e përdorën këtë informacion në mënyrë strategjike në zgjedhjet e 2014-ës për të zhvilluar strategji zgjedhore për fitimin e votave të grave, për të edukuar publikun për rolin e grave në politikë, ose për të demonstruar rëndësinë strategjike të votave të grave. Një arsye për këtë është vështirësia e marrjes së të dhënave zyrtare të zbërthyer në baza gjinore mbi modelet e votimit dhe statistikave.

- Rekrutimi jo formal dhe procesi i emërimit i la gratë të pafavorizuara për shkak të rrjeteve të dominuara nga meshkujt dhe afatit të shkurtë për rekrutim. Femrat shpesh janë rekrutuar në minutën e fundit për të plotësuar numrin minimal të pozitave të kërkuara ligjërisht.
- Ata që janë në detyrë dhe garojnë prapë, veçanërisht në pozita udhëheqëse, kryesisht janë meshkujt. Të njëjtit kanë marrë shumicën e burimeve financiare, mbështetjen politike dhe paraqitjen gjatë fushatës. Si rezultat, shumica e grave, shumë nga ato që po bënin fushatë për herë të parë nuk ishin në gjendje të bëjnë fushatë efektive ose të zhvillojnë profilin e tyre publik për ta bërë emrin të njohur.
- Kur propozohen kandidatët, në degët e partive rrallë herë emërojnë gra. Liderët e degëve zakonisht janë ndër të parët që propozohen, dhe krejt pak janë femra. Degëve të partive u mungon strategjia për rekrutim dhe mbajtje të grave anëtare mes ciklit zgjedhor, dhe kanë një rreth të vogël të kandidatëve potencial për të zgjedhur. Si rezultat, selitë e partive shpesh duhet të fusin kandidatët e tyre femra për të plotësuar kuotën duke anashkaluar të nominuarit e degës.
- Reforma gjithëpërfshirëse zgjedhore dhe rritja e pjesëmarrjes së grave në proceset politike do të paraqesë mundësi të rëndësishme për Kosovarët për të forcuar besimin në sistemin politik.
- Gratë në komunitetet e pakicave përballen me sfida edhe më të mëdha kulturore për të marrë pjesë në politikë, duke përfshirë rezistencë më të madhe kulturore ndaj grave në politikë, si dhe mungesës së mundësive të arsimimit dhe të punësimit.

Ka shumë pak mekanizma brenda partive politike përmes të cilëve femrat janë në gjendje të hyjnë në udhëheqje politike apo për të ndjekur një pozitë të zgjedhur në Kosovë. Ka një mospërputhje në mes të asaj se çfarë thonë udhëheqësit dhe atë që thonë gratë e intervistuar. Udhëheqësitë partiake në mënyrë të njëtrajtshme kanë raportuar që nuk janë në gjendje të rekrutojnë gra mjaftueshëm të kualifikuara për të siguruar përfaqësimin e barabartë brenda listave të kandidatëve në parti. Shumë gra të intervistuar folën për sfidat e mëdha dhe pengesat për të hyrë në politikë, duke përfshirë edhe mbështetjen e pamjaftueshme financiare dhe politike nga partitë, dhe perceptimet se mjedisi politik është armiqësor për aspiratat dhe nevojat e grave.

Që të arrihet një pjesëmarrje kuptimplote e grave në politikë kërkon ndërtimin e kapaciteteve të grave kandidate, duke rritur hapësirën brenda partive politike dhe duke nxitur vullnetin politik mes udhëheqësive partiake. Ekipi i vlerësimit arriti në përfundimin se janë ende të nevojshme përpjekje më të mëdha në tri kategori, në vijim:

- 1) Rritja e kapaciteteve të partive për të mbajtur gratë: Partitë nuk janë në gjendje të tërheqin gratë si anëtare të partisë dhe nuk zhvillojnë dhe mbajnë gratë përmes programeve të zhvillimit të lidërshpit.
- 2) Rritja e hapësirës për gratë: Strukturat partiake vendim-marrëse dhe pozitat udhëheqëse në nivel kombëtar dhe në degë janë të paarritshme për shumicën e grave. Përveç kësaj, partitë nuk kanë vullnet dhe aftësi për të krijuar hapësirë

për gratë kompetente dhe të talentuara. Ka pak mundësi për gratë të mbajnë pozita partiake ose qeveritare, e kjo do të mund të nxiste vlerësim më të madh për kontributin e grave në partitë e tyre.

- 3) Vullnet më i madh politik për të krijuar pjesëmarrje domethënëse të grave: Për shembull, të gjithë liderët e partive politike pranojnë të mirën e kuotës gjinore, por këtë kuotë e përcjellin më tepër në letër se në frymen e saj. Partitë shpesh gratë nuk i marrin seriozisht si anëtare, udhëheqëse apo candidate. Shumë shpesh, partitë i rekrutojnë gratë thjesht për të përmbushur kërkesat minimale ligjore për kuotat.

Edhe pse partitë politike mund të pretendojnë të kenë interes në avancimin e grave, kjo retorikë nuk përkthehet domosdoshmërisht në përkushtim real kështu që partitë përballen me sfida të shumta gjatë realizimit. Megjithatë, pjesëmarrja e lartë e votuesve femra në zgjedhjet komunale të 2013-ës ka rritur ndërgjegjësimin e udhëheqësve partiak për fuqinë e votave të grave, e kjo krijoi një mundësi për ndryshim. Është një vlerësim në rritje për fuqinë politike të grave dhe përparësitë që kandidatet gra u sjellin partive duke tërhequr votat e grave, nëse jo domosdoshmërisht vlera e grave si anëtare të partive, apo udhëheqëse dhe zyrtare të qeverisë. Ky raport përshkruan disa nga çështjet e ngritura në takimet e ekipit të vlerësimit dhe ofron një kornizë për tejkalimin e pengesave për rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë në Kosovë.

■ INFORMATË PARARENDËSE

Rëndësia e pjesëmarrjes së grave në politikë është e njohur ndërkombëtarisht. Konventa për t'i dhënë Fund Diskriminimit Ndaj Grave (CEDAW) u bën thirrje shteteve nënshkruese që të sigurojnë të drejtën e barabartë të grave për të qenë të pranueshme dhe për të mbajtur poste publikeⁱ. Në Rezolutën e 2012-ës për Gratë dhe Pjesëmarrjen Politike, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së u bën thirrje të gjitha shteteve që të: " inkurajojnë fuqishëm partitë politike që të largojnë të gjitha pengesat të cilat drejtpërdrejt apo tërthorazi diskriminojnë pjesëmarrjen e grave, të zhvillojnë kapacitetet e tyre për të analizuar çështjet nga një perspektivë gjinore, dhe të miratojnë politika për të përkrahur aftësitë e grave që të marrin pjesë plotësisht në të gjitha nivelet e vendim-marrjes brenda partive politikeⁱⁱ". Organizatat ndërkombëtare ua kanë paraqitur partive praktikat e mira për të mbështetur gratë si anëtare të partive, kandidatë dhe përfaqësuese të zgjedhura. Vlerësimi në mënyrë të veçantë u bazua në standardet e propozuara në Fuqizimin e Grave për Partitë Politike më të Fuqishme, të përpiluara nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në bashkëpunim me NDI, si dhe Doracaku për Promovimin e Pjesëmarrjes së Grave në Partitë Politike të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).

Parimet e Prishtinës, të dala nga Samiti Ndërkombëtar për Fuqizimin e Grave organizuar nga presidentja Atifete Jahjaga më 2012 dhe e mbështetur nga USAID, thotë se "nën-përfaqësimi politik i grave cenon njohjen e shoqërisë me problemet ekonomike, të sigurisë, drejtësisë dhe ato sociale me të cilat ata përballen, dhe gatishmërisë së qeverisë që me të vërtetë t'i trajtojë ato problemeⁱⁱⁱ". Zgjerimi i pjesëmarrjes së grave në politikë çon në përfitime të prekshme për qeverisjen demokratike. Pjesëmarrja e plotë dhe aktive e grave në politikë rezulton në përfitime pozitive duke përfshirë edhe zhvillimin e politikave që janë më të përgjegjshme ndaj nevojave të qytetarëve^{iv}, rritjen e bashkëpunimit përmes linjave partiake^v, dhe paqe më të qëndrueshme.^{vi}

Kur gratë janë të fuqizuara si udhëheqëse politike, ato vende zakonisht shkojnë drejt standardeve më të larta të jetesës dhe zhvillimeve pozitive në arsim, infrastrukturë, dhe shëndetësi. Zgjerimi i pjesëmarrjes në politikë me përfshirjen e grave mund të përmirësojë funksionimin e qeverive, legjislativit dhe partive politike, dhe mund të ndihmojë qeveritë të sigurojnë përfitime më të prekshme për qytetarët.


Përfaqësimi i grave në Kosovë

Kosova ka bërë hapa të rëndësishëm në rritjen e numrit të grave në udhëheqjen politik. Edhe pse numri i grave në pozicione drejtuese ekzekutive mbetet i ulët, prania e grave me ndikim në një pjesë të vogël të pozitave kyçe është duke e ndryshuar qëndrimin publik në lidhje me gratë dhe është duke e krijuar momentin për rritjen e lidershit të grave në të ardhmen. Zbatimi i legjislationit për kuotën gjinore, ka hapur rrugë më të gjëra për pjesëmarrjen e grave në politikë si dhe i ndihmon gratë në tejkalimin e pengesave për pjesëmarrje në politikë. Duke rritur numrin e grave që shërbejnë si model në poste publike, gjithashtu ndihmon në ndryshimin e opinionit publik në lidhje me aftësitë e grave për të marrë pjesë në politikë. Shprehur me numra, 32,5 për qind e anëtarëve të parlamentit (deputetë) janë gra. Për tre nga gjashtë vjet nga pavarësia e Kosovës, një grua ka qenë kryetare e shtetit. Disa gra ministresha në qeveri kanë dhe vazhdojnë të mbajnë poste kyçe, edhe kreu i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) është një grua. Në zgjedhjet lokale të 2013-ës, për herë të parë një kryetare komune u zgjodh grua. Këto janë arritje të rëndësishme që duhet të njihen. Megjithatë, mbeten shumë role udhëheqëse dhe sektorë kyç në Kosovë ku gratë nuk janë të përfaqësuara,

kështu që ende mbeten pengesa domethënëse për pjesëmarrjen e grave.

Ligji zgjedhor i Kosovës rregullon zbatimin e kuotës gjinore prej 30 për qind ulëse në kuvendet komunale dhe atë kombëtar. Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) për herë të parë aplikoi sistemin e kuotave gjinore në Kosovë në tetor të vitit 2000. Rregullorja 39/2000, paraqitur nga UNMIK-u, kërkonte së paku 30 për qind të kandidatëve femra në listat e partive e që gjeti mbështetje të fuqishme nga gratë kosovare dhe shoqëria civile. Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, KQZ-ja duhet të sigurojë që listat e partive të aplikojnë kuotën gjinore në mënyrë që të certifikohen^{vii}. KQZ-ja duhet gjithashtu të zbatojë kuotën gjinore edhe në shpërndarjen vendeve në Kuvend mes partive politike^{viii}. Përderisa disa e kontestojnë vlerën e kuotës gjinore, shumica e shohin pozitivisht futjen e saj në Kosovë, pasi që kjo ka çuar direkt në rritjen e numrit të grave në Asamblenë Kombëtare, Parlamentin e Kosovës.

Numri i Grave deputete të zgjedhura, 2001 - 2014



Shënim: Numrat janë llogaritur nga rezultatet e zgjedhjeve të certifikuar nga KQZ

Përderisa kuota prej 30 për qind në kuvendin kombëtar dhe ato lokale, siç është mandatuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, në pjesën më të madhe është zbatuar, ndërsa Ligji për Barazi Gjinore, i 2004-ës që parasheh që gratë të mbajnë 40 për qind të posteve të emëruara në qeveri nuk është zbatuar. Përfaqësimi i grave në poste qeveritare jashtë kuvendeve bie shumë nën pragun e 40 për qindëshit. Për shembull, analizat e përfaqësimit të grave në kuadër të KQZ-së në zgjedhjet e 2013-ës dhe 2014-ës tregojnë se organet menaxheriale zgjedhore kishin përfaqësim më të ulët se 20 për qind të grave, edhe pse kryetarja e KQZ-së është grua^{ix}. KQZ nuk ka qenë në gjendje të plotësoj nivelin e dëshirueshëm për arsye se partitë nuk kanë emëruar femra mjaftueshëm në komisionet zgjedhore.^x Gratë kanë marrë vetëm tri nga 19 pozitat ministrore dhe nga pesë pozitat e zëvendës kryeministrave në qeverinë e kaluar, formuar më 2010, edhe pse kishin portofola me ndikim. Deri në fund të mandatit në 2014-ën, vetëm një grua vazhdoi të mbajë një post të lartë. Situata është e ngjashme edhe në nivelin e pushtetit lokal.


Rezultatet e zgjedhjeve 2013 dhe 2014

Zgjedhjet lokale të 3 nëntorit të 2013-ës dhe zgjedhjet parlamentare të 8 qershorit 2014 ishin të parat që u mbajtën në tërë territorin e Kosovës, në përputhje me marrëveshjen e normalizimit, të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian (BE), në Bruksel në mes të Kosovës dhe Serbisë. Krahasuar me zgjedhjet e 2010-ës, të cilat u karakterizuan nga mashtrimet e përhapura dhe me përsëritjen e votimeve në disa qendra votimi, të dy zgjedhjet ishin mjaft transparente, të organizuara mirë dhe kryesisht në përputhje me standardet ndërkombëtare, sipas misionit të vëzhgimit të zgjedhjeve vendore të organizuar nga Demokracia në Veprim^{xi}.

Kuota u përmbush në shumicën e 38 komunave të Kosovës. Në katër komuna - Drenas, Pejë, Skenderaj dhe Mitrovicë të Veriut - kuota nuk u plotësua apo zbatua dhe gratë morën më pak se 30 për qind të ulëseve në kuvendet lokale. Kuota është tejkaluar në Kaçanik, Kamenicë, Junik dhe Han të Elezit, ku përfaqësimi i grave në kuvendin komunal është mbi 40 për qind. Hani Elezit udhëheq në këtë me 47 për qind të këshilltarëve të saj komunal që janë gra. Përveç kësaj, kryetarja e parë e komunës në Kosovë, Mimoza Kusari Lila, u zgjodh në Gjakovë në zgjedhjet lokale të 2013-ës, një moment i rëndësishëm që ofron hapësirë dhe motivim më të madh për gratë e tjera që të ndjekin pozita përmes zgjedhjeve.

Që nga viti 2007, Kosova ka pasur sistemin e listave të hapura të partive, në të cilat votuesit mund të votonin për një parti si dhe të zgjidhnin nga kandidatët e renditur me emra në listat e partive. Në zgjedhjet parlamentare, votuesit mund të votonin deri në pesë kandidatë sipas preferencave votuese, dhe mund të votonin për një kandidat në zgjedhjet komunale. Me kalimin e kohës, u rrit numri i grave që u zgjodhën përmes votimit preferencial, duke sinjalizuar mbështetje më të madhe publike për gratë candidate.

Gratë deputete të zgjedhura me votim preferencial, pa kuota




Shënim: Numrat janë llogaritur nga rezultatet e zgjedhjeve të certifikuar nga KQZ

Pjesëmarrja në votime

Pjesëmarrja e grave në votime e ka tejkaluar atë të burrave në të gjitha përveç dy komunave në Kosovë (Skenderaj dhe Drenas) në zgjedhjet lokale të 2013-ës. Kjo shënoi herën e parë në historinë zgjedhore të Kosovës që më shumë gra se burra hodhën votën. Situata ndryshoi në zgjedhjet parlamentare të 2014-ës, në të cilat gati 15 për qind më pak gra votuan krahasuar me zgjedhjet lokale të 2013-ës. Për dallim, pak më shumë meshkuj votuan në zgjedhjet parlamentare krahasuar me zgjedhjet lokale. Arsyet për këtë boshllëk gjinor domethënës në pjesëmarrjen e votuesve janë të paqarta dhe meritojnë hulumtim të mëtejshëm.

Gratë si përqindje e daljes në votim
Zgjedhjet në 2013 dhe 2014




Shënim: Përqindja e atyre që i përkasin gjinisë së caktuar të cilët kanë dalë të votojnë krahas numrit të regjistruar të votuesve të gjinisë së njëjtë

■ GJETJET DHE ANALIZA

Rëndësia e Kuotës Gjinore

Shumica e bashkëbiseduesëve pajtohen se kuota gjinore ka ndihmuar në rritjen e përfaqësimit të grave në parlament dhe në pozita vendimmarrëse. Shumica e grave dhe burrave të intervistuar pajtohen se Kosova nuk do të kishte zgjedhur 39 gra deputete në 2014 pa kuota. Në secilat zgjedhje në vazhdim, më shumë gra janë duke hyrë në parlament në bazë të numrit të votave preferenciale të marra personalisht, se sa nëpërmjet ndarjes së vendeve përmes kuotave. Në zgjedhjet parlamentare të 2014-ës, 20 për qind e pesë (5) ose dhjetë (10) kandidatëve më të votuar në listat e shumicës së partive ishin gra, pavarësisht nga fakti se ato garonin kundër kandidatëve të profleve të larta politike.

Top 10 kandidatët me votim preferencial,
sipas gjinisë



Shënim: Numrat janë llogaritur nga rezultatet e zgjedhjeve të certifikuar nga KQZ

Kishte një pajtim të përgjithshëm që do të ishte e parakohshme të çaktivizohet kuota, sepse do të duhen edhe disa zgjedhje më shumë para se Kosova të mund të arrijë një përfaqësim të barabartë të grave pa pasur nevojë për kuota. Është ende e vështirë për gratë që të fitojnë zgjedhjet me meritën e tyre pasi të kenë siguruar vend në listat e tyre partiake. Gati 75 për qind e grave anëtare të partive të anketuara për këtë vlerësim pajtohen se kuota gjinore duhet të mbetet ende dhe se autoritetet duhet të vazhdojnë ta fuqizojnë kuotën. Fakti që një shumicë prej 86 për qind e të anketuarve beson se gratë nuk janë të përfaqësuar në mënyrën e duhur në shoqërinë kosovare përforcon këtë ndjenjë.

Sfidat e Kuotës

Pavarësisht efikasitetit në ngritjen e qasjes së grave në politikë, kuota mund të përdoret kundër grave. Anëtarët meshkuj të partive që garojnë kundër grave në votim preferencial u thonë përkrahësve se gratë kandidate do t'i fitojnë postet automatikisht përmes kërkesës së kuotës, kështu që nuk ka nevojë të "hidhen votat kot" duke dhënë votat preferenciale për kandidatet gra. Kjo parandalon më shumë gra për t'u zgjedhur dhe mund të shtrembërojë procesin zgjedhor me nën-përfaqësimin e kandidateve gra krahasuar me mbështetjen që janë në gjendje ta mbledhin.

Edhe gratë politike më tepër veçojnë ato që fitojnë postin në bazë të votave se sa ato si rezultat i kuotës. Shpesh, gratë deputete e identifikojnë veten me numrin e votave që kanë marrë në zgjedhjet e fundit. Për t'iu shmangur marginalizimit, gratë që janë zgjedhur si rezultat i kuotës duhet dalluar veten e tyre dhe duhet që në fillim të punojnë që të dëshmojnë se kontributi i tyre bën dallim dhe se ato janë serioze në rolet e tyre si parlamentare dhe vendimmarrëse. Është e rëndësishme që strukturat e grave brenda partive, gratë deputete dhe partitë politike të ndalen së bëri dallime midis grave të zgjedhura përmes mekanizmave të ndryshëm, pasi që gratë deputete duhet të trajtohen me respekt të barabartë.

Pengesat për rekrutimin e grave kandidatë

Futja në listë

Vlerësimi zbuloi se mungesa e gatishmërisë së partive për të krijuar hapësirë më të madhe për gratë si kandidatë në listat e partive është pengesa më e vështirë për gratë që duan të kandidojnë për pozita. Qasjet e partive për futjen e grave në listat e kandidatëve ndryshojnë por ka pak shembuj ku partitë shkojnë përtej kërkesave ligjore të kuotës gjinore.

Ka mundësi të kufizuara për gratë kandidatë për tu futur në listën e partisë së tyre. Emrat e kandidatëve femra vijnë nga krahu i dedikuar i grave brenda partive apo nga udhëheqës të partisë, të cilët u lënë grave që aspirojnë për kandidatë disa mundësi përmes të cilave ato mund të llobojnë në favor të kandidaturave të veta. Pasi që degët e partive rrallë emërojnë gratë, mundësia e gruas për t'u futur në listën e partisë shpesh varet nga mbështetja e udhëheqësve të lartë të partisë, si dhe nga vlera e profilit të tyre publik, financave dhe aftësive për lidhësi partiak. Shumica liderëve të partive me të cilët u takua ekipi i vlerësimit kanë konfirmuar se partitë e tyre e shqyrtojnë përgatitjen paraprake të grave kandidatë në mënyrë të detajuar. Situata është ndryshe me kandidatët meshkuj, të cilët gëzojnë një fushë të gjerë të mundësive përmes të cilave ata mund të fitojnë një vend në listën e partisë, duke filluar nga degët e partive, e deri te presidenca e partisë dhe te grupet e interesit brenda dhe jashtë partisë.

Shumica e partive politike në Kosovë nuk i kanë freskuar procedurat e tyre të emërimit apo nuk u përmbahen procedurave zyrtare në praktikë. Si rezultat, partitë shpesh nuk ndjekin praktika transparente që do të krijonin hapësirë më të madhe për gratë dhe të rinjtë. Në këto rrethana, gratë përballen me pengesa strukturore për të hyrë në parti politike, gjë që ka thelluar dhe ngurtësuar strukturat me pushtet dhe ku një numër i vogël individësh ka ndikim dominues mbi vendimet kyçe, siç është lista e kandidatëve të partisë. Për më tepër, këta individë kontrollojnë qasjen në trajnime dhe në mundësi të tjera të përparimit për anëtarët e partive dhe kandidatëve të mundshëm^{xii}.

Ngurrimi për tu kandiduar

Shumë gra nuk shohin ndonjë përparim po të hynin në politikë dhe po t'i hynin një karriere politike e që e bën rekrutimin e grave kandidatë për poste më të vështirë. Një anketë e UNDP më 2014 tregon se vetëm tetë për qind të grave janë përfshirë në parti politike, kundrejt 22 për qind të meshkujve^{xiii}. Disa gra të intervistuar përmendin sfidën e suksesit brenda partive politike që dominohen nga meshkujt, ndikimin që hyrja në

politikë do të kishte në familjet e tyre, mirëqenien apo karrierën, frikën nga vëmendja e tepruar e mediave, dhe mungesën e besimit në aftësinë e tyre për të shërbyer në mënyrë efektive, si arsye të ngurrimit për të kandiduar për poste. Të dhënat e votimit tregojnë se gati një e treta e grave në popullatën e përgjithshme besojnë se gratë zbrapsen nga burrat në partitë politike, dhe se diskriminimi është një shkak i madh i përfaqësimit të ulët të grave në pozita^{xiv}. Gratë e perceptojnë arenën politike si të njëanshme ndaj tyre.

Shumë gra e perceptojnë ambicien politike si një ftesë për hetim publik të jetës së tyre private, e që do të kishte ndikim të drejtpërdrejt në familjet e tyre. Shumica e grave kanë një kuptim pragmatik për nevojën e një përkushtimi të fortë për të kandiduar për poste publike dhe të vendimit për të ndërmarrë sakrifica të rëndësishme në jetën e tyre personale dhe profesionale që kërkohet nga kandidatët për poste politike. Përveç kësaj, disa të intervistuar thanë se gratë ngurrojnë për të ndjekur një karrierë në politikë për arsye ekonomike, pasi që për t'u bërë kandidat mund t'u kërkohet që të heqin dorë nga puna e tyre. Një identitet partizan mund të jetë i dëmshëm për karrierën e grave. Në të gjitha rastet, femrat që kanë hyrë në politikë varen nga mbështetja e familjeve të tyre në mënyrë që të tejkalohen pengesat e shumta^{xv}.

Gratë në komunitetet pakicë

Gratë nga komunitetet pakicë përballen me pengesa shtesë për të hyrë në politikë. Shumë komunitete minoritare jetojnë në komunat e vogla rurale me vlera tradicionale që nuk mbështesin pjesëmarrjen e grave në politikë^{xvi}. Si rezultat, ka mungesë të përkrahjes familjare për pjesëmarrjen e grave në politikë në çdo nivel. Partitë minoritare kanë më pak burime dhe më pak qasje në pozita vendimmarrëse krahasuar me partitë e shumicës. Në këtë kontekst, partitë joshqiptare kanë hapësirë edhe më të kufizuar për gratë për t'u ekspozuar dhe për të dëshmuar aftësitë e tyre për të kandiduar për poste dhe për të qeverisur në mënyrë efektive.

Pengesa e parë për pjesëmarrje në politikë për gratë e pakicave është përjashtimi nga hyrja në qeverisjen lokale. Shumica e komuniteteve minoritare jetojnë në zonat rurale ku mënyra më efektive për të filluar një karrierë politike është të shërbesh në qeverinë lokale para avancimit në nivel kombëtar. Megjithatë, pozicionet e qeverisjes lokale të komunitetet pakicë janë të rezervuara dhe zakonisht mbahen nga meshkujt. Burrat gjithashtu mbajnë procese të rëndësishme vendimmarrëse në mjedise joformale pas orarit të punës, për ç'gjë gratë janë të dekurajua nga rrethi për të qenë jashtë shtëpisë ose pse kanë për të përmbushur obligime familjare, e që kontribuon në përjashtimin e tyre nga politika lokale.

Një tjetër pengesë e identifikuar nga të intervistuarit nga pakicat është mungesa e strukturave partiake për të rekrutuar dhe për të përgatitur më shumë gra për të marrë role udhëheqëse. Konteksti kulturor dhe mungesa e mbështetjes financiare dhe e fuqizimit ekonomik në komunitetet pakicë gjithashtu kontribuon në mungesën e pjesëmarrjes së grave. Përveç kësaj është një vlerësim i përgjithshëm se është shumë më vështirë për partitë e pakicave që të angazhojnë gratë nga zonat rurale, ku shumica e komuniteteve pakicë edhe jetojnë, duke theksuar edhe problemet që i kanë me qasjen në arsim dhe punësim.

Përkundër këtyre pengesave, ka raste të shumta të grave kandidate nga pakicat që kanë ndryshuar qëndrimet dhe besimet e anëtarëve të familjeve të tyre pas arritjes

në role drejtuese. Tejkalimi i këtyre pengesave u mundësoi atyre që të kenë sukses dhe të vazhdojnë të jenë aktive në jetën publike dhe politike. Rekrutimet e vonshme të kandidatëve

Ekipi i vlerësimit gjeti një pajtim të gjerë se koha e shkurtër që i parapriu zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në qershor 2014 ishte pengesë për të rekrutuar më shumë gra dhe për inkurajimin e tyre të kandidohen për poste. Ky afat kohor i shkurtër la pak kohë për rekrutimin e kandidatëve, përgatitjen dhe fushatën. Të dy palët si partitë edhe kandidatët ngritin çështjen e rekrutimit të vonshëm të kandidatëve. Në njërën anë, partitë shprehën nevojën për të rekrutuar gra më herët, para afatit të fundit ligjor për dorëzimin e listave të tyre të kandidatëve përpara zgjedhjeve. Përndryshe, partitë pranojnë që ata do të vazhdojnë të përballen me pengesa për të zgjedhur gratë. Në anën tjetër, zyrtarët e partive i treguan ekipit të vlerësimit që vetë kandidatet shpesh parandalojnë rekrutimin e hershëm të kandidatëve, pasi që shumë kandidatë nuk janë të gatshme të braktisin punën e tyre apo të identifikohen me një parti politike aq shumë përpara zgjedhjeve. Për këtë arsye, ndër të tjera, sistemi i tanishëm favorizon funksionarët të cilët janë në gjendje të ndërtojnë profilet e tyre dhe të lidhen me qytetarët gjatë gjithë mandatit.

Sfidat gjatë periudhës së fushatës

Profili i ulët publik

Të intervistuarit pajtohen se për femrat në politikë është e rëndësishme të ndërtojnë një profil të fuqishëm publik dhe medial. Në çdo shembull, gratë kandidatë të cilat kanë qenë të suksesshme në tërheqjen e një numri të madh të votave i falënderohen profilit të tyre medial dhe aftësive superiore të komunikimit, si faktor të mëdhenj në suksesin e tyre. Rekrutimi në moment të fundit i kandidatëve në zgjedhjet e qershorit 2014 i vuri në disavantazh gratë kandidatë në përgatitjen e fushatës. Shumica e grave kandidatë nuk kishin të krijuar një profil publik, e kjo e bëri më të vështirë tërheqjen votave për to. Shumë parti i deklaruan ekipit të vlerësimit se, edhe pse ata ishin të kënaqur me kalibrin e grave të rekrutuara nga partia, kandidatet gra nuk ishin në gjendje të lidhen me qytetarët dhe të tërheqin votat brenda një fushate zgjedhore 10-ditore, pavarësisht se ishin të artikuluar dhe kishin përgatitje mbresëlënëse profesionale. Afati i shkurtër kohor për përgatitjen e fushatës do të thoshte se vetëm disa prej këtyre grave kandidatë ishin në gjendje për t'u zgjedhur.


Problemi i profileve joadekuate publike është i përbërë nga mungesa e mundësive të mediave për gratë kandidatë, përmes të dyja mënyrave: mundësive mediale që ju është dhënë nëpërmjet ngjarjeve të ndryshme dhe kohës së paguar në media nëpërmjet partive të tyre. Raporti Preliminar i Misionit Vëzhgues i Zgjedhjeve i Bashkimit Evropian vë në dukje se, "Partitë politike vazhdojnë të dominohen nga meshkujt dhe mediat japin mbulim shumë më të gjerë për kandidatët meshkuj^{xvii}". Një tjetër raport vëzhgimi për zgjedhjet e vitit 2014 nga ana e Demokracisë në Veprim vuri në dukje se pjesëmarrja e grave në ngjarjet e fushatës ishte thjesht "simbolike", pasi që gratë përbënin vetëm 5 për qind të pjesëmarrësve^{xviii}.

Gjatë një fushate 10-ditore, ka pak mundësi për gratë për të marrë pjesë në debate. Ndërkohë që mediat u kërkuan partive që të dërgojnë një kandidatë femër në dy kandidatë meshkuj për debate, në shumicën e rasteve, partitë dërguan kandidatët meshkuj më me përvojë për të përfaqësuar partitë në televizion. Mungesa e

mbështetjes dhe e ekspozimit ishte një faktor kritik për mungesën e suksesit të kënaqshëm zgjedhor për gratë.

Nga gratë e anketuara, anëtare të partive, 62 për qind besojnë se partia e tyre nuk ka një strategji mediale për promovimin e imazhit të grave në politikë.


Hulumtimi online i grave kandidate dhe anëtare të partive: A jeni të kënaqur me promovimin medial të grave nga partitë politike në 2014?



Stereotipet dhe portretizimet gjinore

Ekipi gjeti mendime të ndryshme për nivelin e diskriminimit në media dhe të stereotipizimit që ekziston në mediat kosovare. Në shumë raste, kundërshtarët përdorën moshën dhe gjininë e grave si argumente kundër kandidaturës së tyre. Të dhënat për votimet nga UNDP-ja konfirmojnë se popullsia e përgjithshme ka tendencë që të lidhë meshkujt me poste politike dhe shumë prej të intervistuarve thonë se votuesit priren të favorizojnë burrat karshi grave si kandidat. Modelet e votimit nga dy zgjedhjet e fundit mbështesin argumentin se qytetarët janë më shumë të prirë të japin votën e tyre për një burrë se sa për një grua kur hedhin vota preferenciale. Sipas rezultateve të zgjedhjeve të 2014-ës, votuesit preferuan të hedhin vota preferenciale për burrat në raport prej katër me një. Megjithatë, shumica e njerëzve të intervistuar, duke përfshirë gratë kandidate në zgjedhjet e fundit, nënvizojnë zgjedhjen e kryetares së komunës grua dhe rritjen e grave kandidate të zgjedhura pa kuota, si dëshmi se kjo situatë është duke u përmirësuar ngadalë, kryesisht për shkak të një numri më të madh të grave në role udhëheqëse, e kjo është duke ndihmuar për të ndërruar qëndrimet.

Përqindja e shkruar e votuesve për kandidatet femra kundrejt meshkujve me votim preferencial



Disa të intervistuar shprehën besimin se gratë nuk mbështesin gratë tjera për t'i ndihmuar ato të zgjidhen. Përderisa kjo teori ishte shprehur disa herë gjatë vlerësimit, ekipi mundi të gjejë pak prova për ta mbështetur atë. Në fakt, gjatë tri fokus grupeve të grave aktiviste politike, ka pasur pak negativitet të shprehur ndaj ndonjëres prej grave që mbajnë role udhëheqëse, dhe shumë gra nuk hezituan t'i quajnë gratë nga partitë e tjera politike si "të guximshme", "profesioniste" ose "kompetente".

Megjithatë, ekipi vlerësues nuk ka gjetur prova për bashkëpunim spontan apo mbështetje për gratë në politikë nga gratë në biznes, në media dhe në shoqëri civile. Do të dukej se përkundër rritjes së numrit të grave që janë tani në skenën politike në Kosovë, pengesat për bashkëpunim mes grupeve të grave të ndryshme në shoqërinë kosovare ekzistojnë.


Mungesa e mundësive të rrjetëzimit

Gratë nuk kanë mundësi të qasjes në rrjete të cilat burrat në mënyrë rutinore i përdorin për të ngritur profilet e tyre. Kandidatet gra i vunë në dije ekipit vlerësues se kanë pak mundësi qasjeje në rrjete, veçanërisht në zonat rurale, gjë që e bën më të vështirë për gratë të lidhen me votuesit dhe të kërkojnë mbështetjen e tyre. Mjediset në të cilat diskursi politik lokal është tradicional, si odat në familjet tradicionale shqiptare, janë në mënyrë tipike të zotuar nga burrat dhe janë pak të arritshme për gratë. Vendimet se cilët kandidat do të mbështesin partitë shpesh janë bërë në mjedise të tilla, përsëri duke i dëmtuar gratë kandidate, duke ua pamundësuar pjesëmarrjen.

Mungesa e ndihmës financiare prej partive


Partitë politike të intervistuar nga ekipi i vlerësimit zakonisht raportojnë se kandidatet gra nuk i kanë burimet e nevojshme për të filluar një fushatë të fortë parazgjedhore. Shumica e partive deklarojnë se ata nuk ishin në gjendje të ofrojnë mbështetje financiare apo trajnime për kandidatet para zgjedhjeve. Një parti ofroi një nivel modest të mbështetjes për të gjithë kandidatët duke u ofruar atyre fletëpalosje, materiale dhe mbështetje në komunikim. Një tjetër parti i tha ekipit të vlerësimit se me kandidatët kanë qenë të sinqertë dhe ju kanë treguar se duhet të jenë të vetë mbështetur dhe të financuar në mënyrë të pavarur. Kjo politikë ndikon si në kandidatët meshkuj ashtu edhe femra, por gratë mund të kenë më pak mundësi apo gatishmëri për të shpenzuar financat personale në një fushatë politike. Sa për krahasim, kandidatët meshkuj shpesh kanë qasje më të madhe në burimet partiake si dhe në mundësitë për mbledhjen e fondeve nëpërmjet rrjeteve të ndryshme të biznesit të cilave ata edhe u përkasin. Në raste të tjera, kandidatët që kanë lidhje familjare me udhëheqjen e një partie apo themeluesit e saj kanë avantazhe të dallueshme për të fituar zgjedhjet, e kjo marginalizon më tej grupet e tilla si gratë.

Hulumtimi online i grave kandidate dhe anëtare të partive: A i mbështet partia juaj kandidatet femra dhe meshkuj dhe me burime financiare të barabarta?



Përveç kësaj, shumica e grave i tha ekipit se partitë politike nuk kanë ofruar ndonjë trajnim apo udhëzime për fushatë për kandidatët në garë për herë të parë. Gra të tjera që kanë pasur më shumë përvojë kanë qenë më mirë në optimizimin e mediave sociale, por ishin të kufizuara në fushata të vogla në rrethet, në lagjet apo fshatrat e tyre. Shumë pak gra kandidate kanë pasur ekipin e tyre personal të fushatës dhe një operacion të fokusuar të fushatës.

Hulumtimi online i grave kandidate dhe anëtare të partive: A ka ndërmarrë partia juaj trajnime për gratë kandidate?



Shumica e grave anëtare të partive të anketuara shprehin mendimin se ekziston një mungesë e mbështetjes së nevojshme, duke përfshirë edhe mbështetjen financiare dhe të ngritjes së aftësive, për kandidatet gra që të jenë në gjendje për të garuar në mënyrë të barabartë me kolegët e tyre meshkuj.

Konkurrenca e brendshme partiake

Kandidatet gra përballen me konkurrencë të brendshme më të madhe për shkak të gjinisë së tyre dhe mungesës së një përvoje në udhëheqje. Përderisa sistemi i votimit preferencial u lejon grave kandidate të ndërtojnë një bazë popullore të mbështetjes së tyre, kjo i detyron ato që të konkurrojnë kundër kolegëve anëtarë të partisë. Pavarësisht mbështetjes së fuqishme lokale dhe kredencialeve të mira, shumë femra më tutje duhet të konkurrojnë me kandidat të njohur meshkuj për pesë pozitat në dispozicion në fletën e votimit preferencial. Partitë i dëmtojnë gratë kandidate duke promovuar kandidatët e favorizuar, shumica prej tyre meshkuj, dhe dekurajojnë alokimin e resurseve për gratë mbi bazën se kuota do tu sigurojë pozitat. Në një rast, NDI mësoi se një parti mbante dy lista, një për gratë dhe një për burrat, për të promovuar kandidatët meshkuj. Shumë gra kanë raportuar se ky konkurrim i brendshëm i dekurajon ato që të kërkojnë post politik.

Pas zgjedhjeve

Përgatitja e grave për role vendimmarrëse

Me një numër të madh të pjesëmarrjes në votime në të dy zgjedhjet, lokale dhe kombëtare, ka shumë anëtarë të rinj të gatshëm të futen në role si vendimmarrës. Ekipi i vlerësimit ka gjetur pak prova se partitë politike do të përgatisin anëtarët e tyre të zgjedhur me trajnime ose udhëzime, dhe ka të ngjarë që mbushja e këtij boshllëku t'u mbetet OJQ-ve dhe organeve të zgjedhura për këtë punë.

Orientimi i anëtarëve të rinj është edhe më kritik për gratë deputete nga pakicat për anëtarët, të cilët kanë pak mentorë për t'i mësuar, edhe më pak kolegë me të cilët mund të punojnë, dhe që përballen me detyrën sfiduese të përfaqësojnë zgjedhësit nga radhët e pakicave dhe të avokojnë për çështjet dhe prioritetet e tyre.

Mbajtja e grave si anëtare të partive gjatë cikleve jo-zgjedhore

Udhëheqësit e partive njëzëri pajtohen që partitë luftojnë për të mbajtur anëtarët gra të angazhuara në mes të cikleve zgjedhore. Mungesa e trajnimit dhe mundësive për të udhëhequr i dekurajon gratë nga përfshirja e mëtutjeshme në politikë. Thjesht vendosja e grave në listat e kandidatëve nuk është e mjaftueshme. Për më tepër, partitë nuk kanë një strategji për mbajtjen e kandidateve femra që nuk fitojnë zgjedhjet dhe për përgatitjen e tyre për ciklin e ardhshëm zgjedhor.

■ REKOMANDIMET

Forcimi i kornizës ligjore në mbrojtje të pjesëmarrjes së grave në politike

Duke pasur parasysh rëndësinë e kornizave ligjore të tilla si kuota gjinore, në krijimin e hapësirës për të tejkaluar pengesat për pjesëmarrjen e grave në politikë, për të siguruar një mjedis të përshtatshëm për gratë për të hyrë në politikë, NDI rekomandon si në vijim:

- Të ndërmerret një shqyrtim i ligjit zgjedhor dhe ligjit për barazi gjinore^{xix} dhe zbatimin e tyre për të siguruar pjesëmarrjen politike të grave më të madhe dhe më efektive. Ligji për barazi gjinore dhe ai zgjedhor dhe çdo propozim për ligjet që qeverisin partitë politike duhet të jenë në përputhje. Kjo kornizë ligjore duhet të përfshijë sanksione dhe dënime të zbatueshme.
- Të mbështetet synimi i kuotës gjinore si një mekanizëm për përfaqësim të barabartë dhe një njohje publike për përfitimet që ka dhënë kjo kuotë duke vendosur gratë në poste politike dhe në ndryshimin e qëndrimeve ndaj grave. Partitë duhet të përqafojnë frymën e kuotës gjinore duke zhvilluar strategji për të rekrutuar dhe mbajtur gratë si anëtare të partive, me përgatitjen dhe mbështetjen e tyre për të kandiduar si kandidatë të suksesshme, dhe duke mbështetur gratë si udhëheqëse në parti dhe në qeveri.
- Organizatat e shoqërisë civile duhet të monitorojnë zbatimin e kuotave gjinore, si dhe efektet e saj.

Të kuptojmë dhe t'i përgjigjemi fuqisë së votimit të grave

Gratë demonstrojnë mundësitë e fuqisë së tyre zgjedhore në zgjedhjet komunale të 2013-ës. Partitë politike do të rrisin performancën e tyre në votime me të kuptuar më mirë çështjet me rëndës për votuesit femra dhe duke zhvilluar platforma të fushatës dhe agjenda të qeverisjes për trajtimin e tyre.

- Partitë politike duhet të ndërmarrin kërkime mbi modelet e votimit të grave për të kuptuar preferencat e grave, çështjet prioritare, qëndrimet dhe trendët. Hulumtimet duhet të fokusohen gjithashtu në kandidatet femra - pse ato kandidohen dhe pengesat që ato hasin - rolin e shoqërisë civile në mbështetjen e grave, dhe perceptimet publike të grave në politikë. Hulumtim i tillë do t'u mundësojë partive që të zhvillojnë strategji më efektive zgjedhore.
- Të dhënat të zbërthyer për sjelljen e votuesve në baza gjinore duhet t'i ofrohen publikut nga KQZ-ja në kohën e duhur dhe në formate të përshtatshme digjitale.
- Partitë politike të pakicave duhet të hulumtojnë për burime shtesë, si hulumtimi i opinionit publik, tubimet e brendshme partiake dhe dialogu me anëtarët, e të cilat mund të shfrytëzohen në mënyrë që të kuptohet gjendja specifike e pjesëmarrjes politike të grave në komunitetet e pakicave.

Rekrutimi dhe mbajtja e grave në kandidim për poste

- Partitë duhet të bëjnë rekrutimin e kandidatëve në kohë të mjaftueshme nga koha kur priten zgjedhjet e ardhshme. Përzgjedhja e kandidatëve duhet të jetë formale, e formuluar në mënyrë të qartë dhe transparente^{xx}. Për shembull, kandidatët

duhet të rekrutohen më shumë se një muaj para zgjedhjeve, dhe partitë duhet të prezantojnë kriteret për procesin e rekrutimit.

- Partitë politike duhet të bëjnë përpjekje më të mëdha për të mbajtur gratë në kandidim për postet e ardhshme, veçanërisht gjatë cikleve jo-zgjedhore duke përfshirë gratë në aktivitete të tilla si programet e trajnimit, tryezat e rrumbullakëta për diskutim të politikave dhe në ngjarje të partive në nivele degësh.

Të rritet mbështetja në fushatë për gratë kandidate

- Lidërshipi politik i partive duhet të dedikojë burime të barabarta për gratë kandidate, duke përfshirë mbështetje në njerëz dhe atë financiare, ekspozimit në media dhe të natyrave të tjera.
- Shoqëria civile, përfshirë mediat, duhet të ndërmarrin masa që aktivisht të angazhohen në edukimin e votuesve në ndjeshmëri gjinore dhe në përfitimet nga pjesëmarrja e grave në politikë.
- Partitë politike duhet të sigurojnë lidërship të balancuar gjinor në mitingje, takime, dhe paraqitje mediale.

Të krijohen struktura partiake dhe pozita udhëheqëse gjithëpërfshirëse

- Të gjitha partitë politike duhet të sigurojnë përfaqësim më të madh të grave në strukturat partiake, sidomos në nivelet e degëve dhe të miratojnë deklaratë të qartë për barazi gjinore, në përputhje me standardet ndërkombëtare^{xxi}. Për shembull, në nivel dege, zëvendëskryetarët duhet të jenë të gjinisë tjetër nga ajo e udhëheqësve të degëve.
- Partitë duhet të konsiderojnë miratimin e rregulloreve për t'i parandaluar individët nga mbajtja e shumë posteve dhe pozitave udhëheqëse në strukturat e tyre, në mënyrë që të ketë më shumë hapësirë për gratë dhe të rinjtë.
- Në mungesë të një ligji për qeverisjen e partive politike, partitë duhet të hulumtojnë drejtimit e qasjes në mënyrë që të sigurojnë balancë gjinore në radhët e udhëheqjes, duke reflektuar në praktikën e familjeve përkatëse partiake evropiane.
- Partitë politike duhet që formalisht të shpërndajnë përshtetjet e përgjithshme të llojeve dhe roleve të posteve brenda partive, siç janë ato në nivel dege, dhe posteve të emëruara institucionale në nivel lokal dhe kombëtar, për të siguruar që gratë janë të informuara për mundësitë e përparimit brenda partive.
- Selitë e partive duhet të inkurajojnë përfaqësim më të madh të grave në udhëheqësitë e degëve duke i komunikuar përfitimet e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe duke avancuar institucionalizimin e praktikave më gjithëpërfshirëse në lidërship në nivelet e degëve.

Të zhvillohet lidërshipi i grave

- Partitë politike duhet të hulumtojnë mundësitë për të siguruar që në vazhdimësi të jepen trajnime për zhvillimin e aftësive për gratë anëtare.
- Partitë duhet të sigurojnë trajnime për aftësitë e qeverisjes për gratë dhe burrat duke paraparë pozitat udhëheqëse.
- Partitë duhet të ndërmarrin masa që të sigurojnë mundësi politike për gratë jashtë posteve, si caktimi nëpër poste ekzekutive në nivel lokal dhe kombëtar, në postet e lidërshipit partiak, dhe në postet e qeverisjes lokale.

■ PËR NDI-në

I themeluar në vitin 1983, Instituti Kombëtar Demokratik (NDI) është një organizatë jofitimprurëse, jopartiake, jo-qeveritare që i përgjigjet aspiratave të njerëzve në mbarë botën për të jetuar në shoqëri demokratike që njohin dhe promovojnë të drejtat themelore të njeriut. Që nga themelimi i saj më 1983, NDI dhe partnerët e saj lokalë kanë punuar për të mbështetur dhe forcuar organizatat politike dhe qytetare, për të mbrojtur zgjedhjet dhe për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve, transparencën dhe llogaridhënien në qeveri. Me anëtarët e stafit dhe vullnetarët praktikantë politik nga më shumë se 100 kombe, NDI bashkon individë dhe grupe për t'i këmbyer idetë, njohuritë, përvojat dhe ekspertizën. Qasja shumëkombëshe e NDI-së përforcon mesazhin se ndërsa nuk ka një model të vetëm demokratik, disa parime themelore pranohen nga të gjitha demokracitë.

Puna e Institutit mbështetet në parimet e mishëruara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. NDI beson se pjesëmarrja e barabartë e femrave në politikë dhe qeveri është thelbësore për ndërtimin dhe ruajtjen e demokracisë. Përbërë nga më shumë se 50 për qind e popullsisë së botës, gratë vazhdojnë të jenë të nën-përfaqësuar si votues, udhëheqës politikë dhe zyrtarë të zgjedhur. Demokracia nuk mund vërtetë t'u shërbejë të gjithë qytetarëve të saj në qoftë se gjysma e popullsisë mbetet e nën përfaqësuar në arenën politike. NDI ndihmon gratë të fitojnë mjetet e nevojshme për të marrë pjesë me sukses në të gjitha aspektet e procesit politik. Programet tona angazhojnë gratë në legjislaturë, parti politike dhe në shoqërinë civile si liderë, aktivistë dhe qytetarë të informuar. Këto programe krijojnë një mjedis ku gratë mund të avokojnë për çështje politike, të kandidojnë për poste politike, të zgjidhen, të qeverisin në mënyrë efektive dhe të marrin pjesë në çdo aspekt të jetës qytetare dhe politike.

Që nga viti 1999, Instituti ka zhvilluar programe të demokratizimit që kontribuojnë në zhvillimin e partive politike gjerësisht të përfaqësuar, institucioneve efektive të qeverisjes, dhe një shoqërie civile të gjallë në Kosovë. NDI punon për të forcuar institucionet kyçe politike kosovare, veçanërisht parlamentin, dhe për të krijuar kanale të duhura nëpërmjet partive politike dhe shoqërisë civile nëpërmjet të cilave të gjithë qytetarët mund të marrin pjesë në sistemin e zhvillimit politik të vendit, si votues, si avokues dhe si mbikëqyrës. NDI shpreson që ky raport do të kontribuojë në këtë punë në vazhdim.

FUSNOTAT


- i CEDAW, Neni 7 shtetet, "Partitë shtetërore do të marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në jetën politike dhe publike të vendit dhe, në veçanti, tu sigurojnë grave, që në kushte të barabarta me burrat, të drejtën ... të jenë të pranueshme për zgjedhje në të gjitha organet e zgjedhura publikisht. dhe (b) Të marrin pjesë në përgatitjen e politikave qeveritare dhe në zbatimin e tyre si dhe për të mbajtur poste publike dhe të kryejë të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisë. "
- ii Rezoluta e OKB-së e Asamblesë së Përgjithshme 66/130 për Gratë dhe Pjesëmarrjen Politike, 2012.
- iii Parimet e Prishtinës, tetor 2012, <https://www.ndi.org/files/Pristina-Principles-FINAL.pdf>.
- iv A. Cammisa, dhe B. Reingold, "Gratë në Legjislaturat shtetërore dhe Kërkimet Shtetërore Legjislative: Përtej ngjashmërisë dhe Ndryshimit", Politika Shtetit dhe Politika Tremujore Vol. 4, Nr.2 (2004): 181-210, <http://www.jstor.org/stable/40421515>.
- v C.S. Rosenthal, "Modelet gjinore në Komitetet legjislative" Gratë dhe Politika Vol. 21, No. 2 (2001): 21-46, http://dx.doi.org/10.1300/J014v21n02_02.
- vi C. Chinkin, "Marrëveshjet e Paqes si mjet për promovimin e barazisë gjinore dhe sigurimin e pjesëmarrjes së grave" Kombeve të Bashkuara: Divizioni për Zhvillimin e Grave (2003), <http://www.un.org/womenwatch/daw/egm/peace2003/reports/bpchinkin.PDF>.
- vii Ligji Nr 03 / L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (neni 27).
- viii Ligji Nr 03 / L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (neni 111,6).
- ix Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore (IFES), "Analiza gjinore e Komisioneve Zgjedhore Komunale, Komisioneve të vendvotimeve dhe të Menaxherëve të qendrave të votimit në zgjedhjet komunale të nëntorit 2013 në Kosovë", mars 2014.
- x Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore (IFES), "Analiza gjinore e Komisioneve Komunale Zgjedhore, Komisioneve të Vend-votimeve dhe Menaxherëve të Qendrave të Votimit në nëntor 2013, Zgjedhjet Lokale në Kosovë", Mars 2014.
- xi Demokracia në Veprim, "Zgjedhjet e Përgjithshme 2014: Zgjedhjet e jashtëzakonshme me sfidat e zakonshme," Demokracia në Veprim, 2014, në dispozicion në: [http://www.demokracia.ne.veprim.org/publikime/RE Observation 2014.pdf](http://www.demokracia.ne.veprim.org/publikime/RE%20Observation%202014.pdf) (Futur më 11 nëntor 2014).
- xii OSBE / ODIHR, Doracak për Promovimin e pjesëmarrjes së grave në partitë politike, OSBE / ODIHR, Varshavë, Poloni, 2014, p. 193.
- xiii UNDP, Kosovë, "Udhëheqja dhe pjesëmarrja e grave në politikë," Raport, 2014, fq Pulsit Publik. 22.
- xiv Ibid, pp. 28-9.
- xv Ngjashëm, një shumicë e burrave dhe grave të anketuara besojnë se presioni familjar, mungesa e mbështetjes shtetërore, traditës, dhe mungesa e grave në biznes janë faktorë kyç që mban gratë anash nga të qenit udhëheqës politik. Po aty, f.16.
- xvi Ibid, p. 10.
- xvii Misioni Vëzhgues i Bashkimit Evropian, "Deklarata paraprake, Zgjedhjet legjislative të Kosovës, 8 qershor 2014, 2014", në dispozicion në: <http://eeas.europa.eu/eueom/>

missions/2014/kosovo/pdf/eueom-kosovo2014-preliminary-statement_en .pdf
(Futur më 15 tetor 2014).

- ^{xviii} Demokracia në Veprim, "Zgjedhjet e Përgjithshme 2014: Zgjedhjet e jashtëzakonshme me sfidat e zakonshme," Demokracia në Veprim, 2014, në dispozicion në: [http://www.demokracia.ne.veprim.org/publikime/RE Observation 2014.pdf](http://www.demokracia.ne.veprim.org/publikime/RE%20Observation%202014.pdf) (Futur më 11 nëntor 2014).
- ^{xix} Programi Legjislativ 2015, aprovuar në mbledhjen e 06 të Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendim nr. 02/06, datë 14.01.2015, "Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 2004/2 për Barazinë Gjinore".
- ^{xx} OSCE / ODIHR Doracak, p. 65. Parimet e Prishtinës bëjnë thirrje për krijimin e "strukturave demokratike brenda partive politike përmes akteve nënligjore, themelimin e transparencës dhe barazisë, dhe procedurave të zgjedhjeve të brendshme që u mundësojnë grave që të marrin pozita udhëheqëse partiake e që bëjnë pushtet autentik." Parimet e Prishtinës, 2011.
- ^{xxi} UNDP dhe NDI, Fuqizimi i Grave për Partitë e Forta Politike: Një Udhëzues për Promovimin e pjesëmarrjes politike të grave, shkurt 2012, f. 4.

Versioni origjinal i këtij raporti është në gjuhën angleze, i cili është përkthyer gjithashtu në gjuhën shqipe dhe serbe.

Për më tepër informata, ju lutemi të vizitoni www.ndi.org.



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

